

1. Kush është hierarkia e autoriteteve të drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ?
2. Cilat janë dokumentet që komandanti i forcës ose strukturës mbështetëse i paraqet Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA për miratim ?
3. Kush janë kompetencat e Kryeministrit në raport me Forcat e Armatosura ?
4. Cili është qëllimi, kompetencat dhe përbërja e Këshillit të Politikave të Mbrojtjes ?
5. Cilat janë rastet kur lirohet ose shkarkohet Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA ?
6. Cili është objekti i ligjit për Karrierën Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, qëllimi dhe juridiksioni territorial (territori) ku gjen zbatim ky ligj.
7. Cilët janë kategoritë e ushtarakëve sipas ligjit për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
8. Cilat janë autoritetet kompetente për titullimin dhe dhënien e gradës së parë për ushtarë, nënoficerë dhe oficerët aktivë ?
9. Çfarë kuptoni me pezullim të ushtarakut nga detyra dhe cilat janë rastet e pezullimit nga detyra sipas ligjit për Karrierën Ushtarake.
10. Cilat janë rastet kur del në rezervë ushtaraku aktiv ?
11. Çfarë është pezullimi disiplinor dhe si është i rregulluar ky element në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në FA të RSH”?
12. A parashikon ligji nr. 173/2014 “Për disiplinën në FA të RSH”, institutin e rehabilitimit. Nëse po, për cilat shkelje parashikohet rehabilitim dhe cilat janë afatet kohore të përcaktuara në ligjin përkatës ?
13. Cilat janë masat disiplinore që mund të jepen nga autoriteti përgjegjës për shkelje shumë të rënda disiplinore dhe një përshkrim i shkurtër i tyre ?
14. Çfarë kuptoni me ecuri disiplinore dhe çfarë duhet të ketë parasysh autoriteti përgjegjës në caktimin e masës disiplinore ?
15. Çfarë rrethanash lehtësuese parashikon ligji i disiplinës dhe kush janë pasojat e kryerjes së një shkelje disiplinore duke qenë në kushtet e rrethanave lehtësuese ?
16. Cilat janë kriteret e përgjithshme për pranimin si ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ?
17. Cila është formula e betimit të oficerit dhe nënoficerit aktiv të FA dhe kur bëhet betimi ?
18. A kanë të drejtë ushtarakët aktivë të bëjnë propozime dhe ankesa, në rast se po ku i adresojnë këto propozime/ankesa dhe a mbajnë përgjegjësi për to ?

**19. Cilat janë ndalimet ndaj ushtarakut të FA për shkak të detyrës ose të shërbimit ?**

**20. Përcaktoni rastet kur humbet statusi i ushtarakut.**

***Referenca:***

*Ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimin e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*

*Ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*

*Ligj nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*

*Ligj nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.*